



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e premte, në datën 11 tetor 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit”. (**Vendimi nr. 152, datë 11.10.2019**)
2. Dhënien e autorizimit, subjektit person fizik Ramazan Rringaj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Puka” në “Njësitë administrative Pukë, Çelëz dhe Fushë-Arrëz”. (**Vendimi nr. 153, datë 11.10.2019**)
3. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Vlora Cable” në “Njësinë Administrative Himarë, Bashkitë Vlorë dhe Selenicë”. (**Vendimi nr. 154, datë 11.10.2019**)
4. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Focus Media News” sh.p.k., dhe lënien të fuqi të vendimit, gjobë nr. 88 datë 07.06.2019 të AMA-s, në masën 150,000 lekë për subjektin audioviziv “TV News 24”. (**Vendimi nr. 155, datë 11.10.2019**)
5. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit Gerantina Zylo dhe lënien në fuqi të vendimit me gjobë nr. 14, datë 10.05.2019, në masën 5,000,000 lekë, për ofrimin e shërbimit të programeve audiovizive mbështetur në internet (IPTV/OTT) pa autorizimin e AMA-s. (**Vendimi nr. 156, datë 11.10.2019**)
6. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Albi Kreçi dhe lënien në fuqi të vendimit me gjobë nr.16, datë 07.08.2019, në masën 2,000,000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit për subjektin “Tv me kabëll Alb Vito Peqin”. (**Vendimi nr. 157, datë 11.10.2019**)

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**